

## KOLEGJI DARDANIA



**Treguesit kryesorë të performancës për programet studimore**

*Ky udhëzues ju shërben të interesuareve që të njoftohen me sektorët të cilët maten për të konstatuar cilësinë e veprimtarisë dhe të shërbimeve që ofron njësia akademike*

**Prishtinë, 2023**

## Fjala e Dekanit

Treguesit e performancës për njësitë akademike të **Kolegjit Dardania** në Prishtinë, padyshim se janë instrumente me rëndësi për matjen e cilësisë të programeve që ofron. Programet studimore që ka ofruar Kolegji Dardania që nga themelimi kanë hapur një perspektivë për arsimimin e të rinjve, të cilët duke u bërë pjesë përbërëse e këtij institucioni të arsimit të lartë në Kosovë. Kolegji Dardania përmes programeve studimore ka mundësuar të ofrojë arsimim cilësor, aftësim të studentëve për profesion dhe punë praktike, si dhe ngritje të kuadrove aq të kërkuara për përmbushjen e nevojave të tregut të punës të Kosovës dhe më gjerë.

*Programet studimore* të Kolegjit Dardania aktualisht ofrojnë kushte të jashtëzakonshme të punës studimore, hulumtuese e organizative. Krahas programeve studimore cilësore, njësitë akademike shquhet për staf akademik cilësorë, kurrikulë bashkëkohore, hapësira imponante pune, mësonjtore, kabinete e laboratorë të pajisur dhe të mirëmbajtur, etj. Stafi akademik i përgatitur dhe me përvojë, administrata e kualifikuar dhe e aftë për mbështetje të mësimdhënies, të punës praktike dhe hulumtimit, kurdoherë në shërbim të studentëve dhe në shërbim të komunitetit.

Njësia akademike kurdoherë ka qenë dhe aktualisht janë të hapura për shërbime në komunitet. Shërbimet në komunitet janë pjesë e misionit dhe vizionit të kurrikulës së programeve ekzistuese. Bashkëpunimi me sektorin publik dhe me sektorin privat konsiderohet segment tepër i rëndësishëm, i cili mundëson shkëmbimin e përvojave, ndërsa studentëve u mundëson kryerjen e praktikës studentore, familjarizimin me vendin e punës dhe aftësimin për realizimin e detyrave, si dhe njohjen e teknologjive të reja.

Njësitë akademike në kuadër të Kolegjit Dardania kanë krijuar mekanizma relevantë në shërbim të studentëve, duke u mundësuar atyre punë cilësore akademike, jetë të begatë studentore, kushte të mira pune, forume diskutimi e argëtim.

Njësitë akademike kujdesen edhe për studentët e diplomuar (ALUMNI), duke bashkëpunuar ngusht me përfaqësuesit e tyre si dhe me punëdhënës, opinionet e të cilëve shyrtohen me kompetencë nga Këshilli shkencor-mësimor i njësisë akademike. Njësitë akademike bashkëpunojnë ngusht me përfaqësuesit e Alumnit dhe të Punëdhënësve me të cilët organizojnë takime të përbashkëta në cikle të rregullta, qoftë kur bëhet planifikimi strategjik, qoftë para se të bëhet vlerësimi i performancës, apo atëherë kur dizajnohen kurrikulat e reja studimore.

Prandaj, manuali të cilin po e promovojmë sot, përcakton treguesit kryesor të performancës të programeve studimore të njërive organizative sipas treguesve specifikë, përmbushja e të cilëve do t'i kontribuojë ngritjes së mëtejme të cilësisë të veprimtarisë së gjithëmbarshme të institucionit. Vlerësimi i drejtë e profesional i përmbushjes së treguesve të performancës konsiderohen indikatorë eminent për trasimin e kahes zhvillimore të njësisë akademike, si pjesë përbërëse e Kolegjit.

Na priftë e mbara!

## **Përmbajtja**

Fjala e Dekanit.....	1
Lista e shkurtesave.....	2
<b>HYRJE.....</b>	<b>3</b>
<b>Treguesit kryesor të performancës .....</b>	<b>5</b>
<b>1. Performanca akademike .....</b>	<b>6</b>
<b>2. Angazhimi i studentëve .....</b>	<b>6</b>
<b>3. Rezultatet kërkimore (për programet MA) .....</b>	<b>6</b>
<b>4. Normat e diplomimit dhe arritshmëria e studentëve.....</b>	<b>7</b>
<b>5. Punësimi dhe zhvillimi i karrierës.....</b>	<b>7</b>
<b>6. Kënaqshmëria e studentëve.....</b>	<b>8</b>
<b>7. Zhvillimi i aftësive të të diplomuarve.....</b>	<b>8</b>
<b>8. Diversiteti dhe gjithëpërfshirja .....</b>	<b>9</b>
<b>9. Performanca financiare e njësisë akademike .....</b>	<b>11</b>
<b>10. Shërbimi ndaj komunitetit/shoqërisë.....</b>	<b>12</b>
<b>11. Akreditimi dhe Sigurimi i Cilësisë së njësisë akademike.....</b>	<b>12</b>
<b>Përfundimi.....</b>	<b>13</b>

### **Lista e shkurtesave**

TKP - Treguesit Kryesorë të Performancës

PASM – Programet studimore

NjA - Njësia Akadematike

KD - Kolegji Dardania

## HYRJE

Treguesit kryesorë të performancës (më tutje TKP), janë elementët e planit të njësive akademike të cilët janë hartuar në bashkëpunim me zyrtarët e Zyrën për Sigurimin e Cilësisë të Kolegjit, mbështetur në Planin Strategjik të Kolegjit, Kurrikulën e Akredituar të secilës njësi akademike. Prandaj, Treguesit Kryesorë të Performancës shprehin rezultatet sasiore që kërkohen të maten për të konstatuar suksesin e arritur të njësisë përkatëse akademike.

Treguesit kryesorë të performancës janë vlera të matshme që aplikohen në institucionet arsimore për të matur dhe përcjellur përparimin në përmbushjen e misionit, vizionit dhe objektivave specifike të njësisë akademike. Treguesit e performancës ndihmojnë njësinë akademike të shprehë numerikisht procesin e monitorimit/vëzhgimit dhe të vlerësojë efektshmërinë e arritur, duke përditësuar formulimin e politikave dhe përcaktimin e synimeve të njësisë.

Treguesit kryesorë të performancës janë masa që ofrojnë informacion dhe të dhëna statistikore, të cilat mundësojnë krahasimin dhe vlerësimin e përparimit drejt një qëllimi të caktuar. Në këtë kontekst TKP janë:

- Mekanizma që ofrojnë informacion dhe të dhëna statistikore që lejojnë krahasimin dhe përcaktimin e përparimit drejt një qëllimi të caktuar;
- Mjet i rëndësishëm administrativ për të monitoruar progresin drejt arritjes së qëllimeve strategjike;
- Janë tregues statistikorë që ofrojnë një “instrument” për matjen e performancës të njësisë akademike të shprehur në tregues numerik për shkallën e përmbushjes të qëllimeve të vëna.

Treguesit kryesorë të performancës janë një nga mjetet që ndihmojnë për t'iu përgjigjur pyetjes së rëndësishme: *Si mund të dimë se çfarë ka arritur njësia akademike?*

Por, pse i duhet njësisë akademike Udhëzuesi për përcaktimin e Treguesve Kryesorë të Performancës?

TKP shërbejnë për të matur:

- Si po funksionon njësia akademike si pjesë përbërëse e Kolegjit Dardania?
- Sa mirë funksionon njësia akademike?
- Çfarë janë politikat vendimarrëse brenda njësisë akademike?
- Çfarë janë të dhënat numerike për performancën e përgjithshme?
- Të identifikohen fushat që kanë nevojë për përmirësim dhe zhvillim.

Cila ishte metodologjia e zhvillimit të treguesve kryesorë të performancës për Kolegjin Dardania?

Gjatë muajve të fundit, në takime të rregullta dhe në bashkëpunim të ngushtë me menaxhmentin e njësive akademike u identifikuan dhe u hartuan Treguesit Kryesorë të

Performancës, mbështetur në Treguesit Kryesorë të Performancës të Kolegjit. Kjo pako e treguesve të performancës së njësishë akademike do të përditësohet në vazhdimësi mbështetur në rezultatet e arritura të njësishë akademike.

Në këtë Udhëzues janë përfshirë njëmbëdhjetë Tregues Kryesorë të Performancës, të cilët konsiderohen mjaft reprezentativë për të ndihmuar njësinë akademike për përmbushjen e misionit, të vizionit, dhe objektivave të *Programet studimore* gjatë periudhës së caktuar kohore.

## **TREGUESIT KRYESORË TË PERFORMANCËS**

Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është kryesori për aktivitetin akademik të Kolegjit Dardania. Ky proces synon të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë e studentëve në aspektin teorik dhe praktik të fushave të ndryshme, me qëllim të përgatitjes së tyre për tregun e punës dhe për kontributin e tyre në zhvillimin e komunitetit. Kolegji Dardania, synon të ofrojë programe akademike të një standardi të lartë të krahasueshme me institucionet e arsimit të lartë në Zonën Europiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Zonën Eurpoiane të Kërkimeve (ERA).

Në vijim do të prezantojmë treguesit e performancës që janë specifikë për mësimdhënie dhe mësimnxënie në Kolegjin Dardania.

### **1. Performanca akademike**

Performanca akademike kalkulohet duke marrë parasysh numrin total të semestrave për të plotësuar kërkesat për diplomim. Përmes grafikëve, prezantohen të dhënat për numrin e studentëve që kanë diplomuar në programin studimor si dhe raportin midis studentëve që kanë diplomuar në kohë dhe atyre që do të duhej të diplomonin.

- 1.1 GPA (mesatarja e pikëve të notave);
- 1.2 Notat mesatare për semestër;
- 1.3 Normat e kalueshmërisë në kurse shprehur në përqindje;
- 1.4 Nota mesatare brenda vitit akademik;
- 1.5 Nota mesatare e gjeneratës brenda tri viteve të fundit.

### **2. Angazhimi i studentëve**

Ky tregues paraqet shkallën e angazhimit të studentëve bazuar në ngarkesën e punës së studentit, dhe suksesin e tyre, në përputhje me specifikat e syllabuseve të programeve të studimit. Ky tregues i performancës paraqet shpërndarjen e aktiviteteve të studentëve, si dhe pjesëmarrjen e tyre në aktivitete mësimore dhe në evenimente tjera të studimit, vit për vit dhe në tri vitet e fundit të studimit.

- 2.1. Normat e pjesëmarrjes në klasë dhe në ngjarje të organizuara;
- 2.2. Pjesëmarrje në seminare, ose aktivitete ekstrakurrikulare që lidhen me fushën e studimit.

### **3. Rezultatet Kërkimore (për programet MA):**

Treguesi i performancës shprehë numrin e hulumtimeve/projekteve, konferencave shkencore, etj. të njësisë akademike në të cilat studentët kanë marrë pjesë si bashkëpunëtorë të stafit akademik vit për vit, dhe në tri vitet e fundit.

- 3.1. Numri i punimeve kërkimore të publikuara;
- 3.2. Citimet e marra për punimet e botuara;
- 3.3. Pjesëmarrja në konferenca kërkimore.

### **4. Normat e diplomimit dhe arritshmëria e studentëve**

Ky tregues paraqet shkallën e arritshmerisë së suksesit të studentëve bazuar në notën mesatare të tyre të dalë nga ngarkesa e punës të studentit, e cila është në përputhje me specifikat e syllabuseve të programeve të studimit.

#### **4.1. Ky tregues i performancës paraqet notën mesatare të studentëve për tre vitet e fundit të studimit.**

- 4.1.1. Përqindja e studentëve që përfundojnë programin në kohë;
- 4.1.1. Përqindja e studentëve që përfundojnë programin gjashtë muaj me vonë;
- 4.1.3. Përqindja e studentëve që përfundojnë programin një vit me vonë;
- 4.1.4. Përqindja e kalueshmërisë së studenteve në vitin e dytë të studimeve;
- 4.1.5. Përqindja e kalueshmërisë së studentëve në vitin e tretë të studimeve.

#### **4.2. Diplomimi i studentëve**

**4.2.1** Performanca mat vlerësimin e studentëve të cilët kanë diplomuar në afatin e duhur kohor.

**4.2.2.** Performanca kalkulohet për secilin njësi akademike ndarazi, duke marrë parasysh numrin total të semestrave për të plotësuar kërkesat për diplomim. Përmes grafikëve, prezantohen të dhënat për numrin e studentëve që kanë diplomuar sipas programeve të

studimit për të gjitha njësitë akademike, si dhe raportin midis studentëve që kanë diplomuar në kohë dhe atyre që do të duhej të diplomonin.

4.2.3. Të diplomuarit tanë

4.2.4 Treguesi i performancës shpreh numrin e studentëve që kanë përfunduar studimet BA në programin *Programet studimore* brenda gjashtë muajve perfundimit të provimeve-semesterave.

## **4.2. Braktisja e studimeve**

Ky tregues përcakton shkallën e përqindjes së braktisjes së studimeve (për arsye të ndryshme) nga studentët e njësisë akademike *Programet studimore*. Ky tregues paraqet raportin në mes të studentëve që i kanë braktisur studimet në krahasim me numrin total të studentëve të regjistruar për tre vitet e fundit.

4.3. Ndërrimi i programit /kalimi i studentëve nga një program në programin tjetër studimor, brenda njësisë akademike.

4.4. Transferimi i studentëve nga një njësi akademike në njësinë tjetër akademike brenda kolegjit.

4.4. Shkalla e braktisjes së studimeve, ose mbajtja e studentëve me kalimin e kohës, shprehur në përqindje (%).

## **5. Punësimi dhe zhvillimi i karrierës**

Ky tregues përcakton shkallën e përqindjes së punësimit të studentëve të diplomuar në njësinë akademike. Ky tregues paraqet raportin në mes studentëve që janë punësuar në krahasim me numrin total të studentëve të regjistruar për tre vitet e fundit.

5.1. Shkalla e punësimit pas diplomimit

5.2. Koha e nevojshme për të siguruar punësim pas diplomimit

5.3. Punësimi në fushat përkatëse

## **6. Kënaqshmëria e studentëve**

**Ky tregues performance ka të bëjë me matjen e nivelit të kënaqshmërisë së studentëve të njësisë akademike sa i përket shërbimeve dhe çështjeve të ndryshme për të cilat janë anketuar përmes pyetësorëve.**



**6.1. Ky tregues performance e mat nivelin e kënaqshmërisë së studentëve për shërbimet që janë përfshirë në pyetësorë rreth mësimdhënies dhe mësimnxënies, po ashtu edhe për shërbimet përkrahëse të ofruara.**

6.1.1. Reagimet ndaj vlerësimeve të studentëve në pyetësorë;

6.1.2. Shkalla e ankesave ose apelimeve të deponuara me shkrim;

6.1.3. Shkalla e ankesave ose apelimeve me shkrim në kutinë e ankesave.

## **7. Zhvillimi i aftësive të diplomuarve**

**Ky tregues performance tregon se sa u kanë ndihmuar realizimi i përmbajtjeve kurrikulare studentëve të diplomuar në njësinë akademike për t'u adaptuar në tregun e punës.**

**7.1. Ky tregues performance na tregon se sa u kanë ndihmuar studimet në Kolegjin tonë studentëve për t'u adaptuar në tregun e punës sipas punëdhënësve.**

7.1.1. Kurset obligative shprehur në përqindje;

7.1.2. Kurset zgjedhore shprehur në përqindje;

7.1.3. Kurset elective shprehur në përqindje.

**7.2. Përvetësimi i aftësive specifike të lidhura me programin:**

7.2.1. Kurset e Teknologjisë **informative shprehur në përqindje**

### **7.2.3. Kurset e përgjithshme**

7.2.3.1 Shkrim akademik/ Hyrje në gjuhën angleze;

7.2.3.2 Metodatat kuantitative të hulumtimit;

7.2.3.3 Metodatat kualitative të hulumtimit .

### **7.3. Ngarkesa javore e studentëve**

Ky tregues mat ngarkesën kohore javore të studentëve në realizimin e kontributit të studentit të paraparë me syllabuse.

**7.3.1. Numri total i orëve sipas semestrave:**

7.3.1.1. Dimëror

7.3.1.2. Veror

### **7.3.2. Raporti teori-praktikë**

Treguesi i performancës së raportit teori-praktikë shpreh mesataren e të gjitha syllabuseve të raportit të pjesës teorike dhe të pjesës së aftësimit praktik brenda:

- 7.3.2.1. Syllabuseve për lëndët obligative shprehur në %;
- 7.3.2.2. Syllabuseve për lëndët zgjedhore shprehur në %;
- 7.3.2.3. Syllabuseve për lëndët elektive shprehur në %;
- 7.3.2.4. Numrit të përgjithsëm të orëve të praktikës në terren me monitorim të dyfishtë.

## **8. Diversiteti dhe gjithëpërfshirja**

**Ky tregues performance tregon se sa njësia akademike është e hapur ndaj komunitetit në respektimin e diversitetit dhe të gjithëpërfshirjes.**

### **8.1. Diversiteti në lidhje me përfshirjen e individëve:**

- 8.1.1. Studentë me nevoja të veçanta;
- 8.1.2. Studentë sipas përkatësisë gjinore;
- 8.1.3. Studentë sipas përkatësisë etnike.

### **8.2 Iniciativat e përfshirjes dhe ndikimi i tyre në trupin studentor**

**Ky tregues performance tregon se sa studentët e njësisë akademike *Programet studimore* janë të përfaqësuar në strukturën/strukturat vendimmarrëse:**

- 8.2.1 Pjesëmarrja në Këshillin shkencor-mësimor;
- 8.2.2 Pjesëmarrja e përfaqësuesve të njësisë akademike në Senatin e Kolegjit.

## **9. Performanca financiare e njësisë akademike:**

- 9.1. Kostoja për student të regjistruar;
- 9.2. Të ardhurat e krijuara për program.

## **10. Shërbimi ndaj komunitetit/shoqërisë**

Si vlerë e shtuar e rolit të njësisë akademike për nxerrjen e të diplomuarëve të nivelit BA, si dhe realizimit të hulumtimeve shkencore cilësore në fushën e shkencave sociale i kushton rëndësi

shumë të madh bashkëpunimit me komunitetin. Njësia akademike luan rol kyç në bashkëpunim me komunitetin përmes kontributit të madh për ofrimin e dijes dhe kontributin në aktivitete shoqërore dhe kulturore.

10.1. Numri i aktiviteteve publike të stafit të njësisë akademike si:

10.1.1 Ligjërata publike;

10.1.2. Publikime të artikujve të ndryshëm nëpër media;

10.1.3. Paraqitje të ndryshme nëpër media për vit akademik dhe për tre vitet e fundit;

10.2. Pjesëmarrja në aktivitete publike jashtë njësisë akademike.

Ky tregues performance e mat pjesëmarrjen e vizitorëve të jashtëm në universitet me rastin e aktiviteteve të ndryshme, si dhe pjesëmarrjen e stafit të Kolegjit Dardania në aktivitete bamirësie apo vullnetare.

## **11. Akreditimi dhe Sigurimi i Cilësisë të njësisë akademike:**

10.1. Pajtueshmëria me standardet e akreditimit;

10.2. Rezultatet nga auditimet ose vlerësimet e jashtme.

## **PËRFUNDIM**

Për qëllime të përmirësimit të cilësisë së njësisë akademike si pjesë përbërëse e Kolegjit Dardania, institucioni ka përcaktuar Treguesit Kryesorë të Performancës të cilët do t'i masin rezultatet e njëmbëdhjetë fushave të përfshira sipas dinamikës së përcaktuar dhe atë jo më pak se për secilin semester (dimëror dhe veror), si dhe së paku një herë në tre vjet (performanca e përgjithshme e programit të akredituar).

Njësitë akademike kanë hartuar treguesit kryesorë të performancës përmes të cilëve identifikojmë pikat e forta, por edhe hapësirat ku ka nevojë për përmirësim.